

STATUTI dhe AKT THEMELIMI I SHOQËRISE “Futura Fusion Technology” SHPK

Mbeshtetur ne Kushtetuten dhe Kodin Civil ne Fuqi te Republikes se Shqiperise , ne ligjin Nr.7512 date 10.08.1991 “ Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private , nismes se lire dhe te veprimitarise private dhe privatizimit ”, te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 . “ Per shoqerite tregtare ” dhe te ligjit Nr.9723 , date 03.05.2007 “Per Q.K.R dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare , me vullnetin tim te lire , te shprehur edhe ne nenshkrimin e ketij akt-themelimi dhe statuti te shoqerise

Kreu I Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1: Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, më 18.05.2022, ne: themeluesit; z. **Rasim Jeshili** shtetas Shqiptar, i biri i Ahmet-it me datëlindje 04.08.1984, lindur ne Rrostej, Durres dhe banues ne Tirane, shtetas shqiptar, madhor, me zotesi te plete juridike dhe per te vepruar, identifikuar nepernjet leternjoftimit elektronik me nr 030818955. i pajisur me nr personal **140804070N** si dhe z. **Andi Gjeta** shtetas Shqiptar, i biri i Ismetit-it me datëlindje 25.08.1987, lindur ne Librazhd, dhe banues ne Tirane, shtetas shqiptar, madhor, me zotesi te plete juridike dhe per te vepruar, identifikuar nepernjet leternjoftimit elektronik me nr 035279086.i pajisur me nr personal **1705280211**, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **“Futura Fusion Technology”** SH.P.K.

Shoqeria gezon statusin e personit juridik (biznes i vogel, pa tvsh).

Neni 2: Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm;

Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet të lejuar nga ligji në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë por pa u kufizuar në: a) Trajnime në fushën e ICT (networking, cloud, design, collaboration, wireless, data center, internet of everything, arduino, raspberryPI, entrepreneurship, security, cybersecurity, server, linux, programming), Burimeve Njerëzore, E-Prokurim, Management dhe Zhvillim Projekteve; b) Shërbime në fushën e sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikacionit, (administrim dhe siguri, telekamerash, zhvillimi software, konfigurim dhe instalim); c) Konsulencë informatike dhe programesh, hartime programesh për fusha të ndryshme të sistemeve informatike, studime, këshillime për probleme të informatikës d) Prodhim dhe shitje programesh informatike dhe aplikacione; f) Aktivitete shitblerje shërbimesh. SUPPORT IT. Etj.

Neni 3: Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e papërcaktuar.

Neni 4: Selia

Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Rruga: Frosina Plaku, Ndertesa 6, Hyrja 13, Kati III, Njesia Bashkiake nr. 7, kodi postar 1023 Tirane.

Kreu II Kapitali

Neni 5

Kapitali themeltar

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100 Lekë (njeqind).
Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

Ortaket themelues :

- z. Rasim Jeshili** zoterues e 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përbën 65 % të kapitalit themeltar të shoqërisë te barabarte me 65 lek.
- z. Andi Gjeta** zoterues e 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përbën 35 % të kapitalit themeltar të shoqërisë te barabarte me 35 lek.

Kapitali kapitali do te shtohet ose te pakesohet ne perputhje me ligjet Shqiptare.
Kontributi i ortakëve do të jetë në para.

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar pér kontributet në para dhe me anë të kontributiveve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak pér të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kerkohen pér ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogelimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;

- ç) dhurimit;
d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organë Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modalitetave te peraktuara ne ligji.
Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqérin, për çështjet e mëposhtme:
a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
b) ndryshimet e statutit;
c) emrërimin e shkarkimin e administratorëve;
ç) emrërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertitëve kontabël të autorizuar;
d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkrinjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimitarisë;
e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimitarisë;
ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
gi) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
Ortaku mund të përfaqësohet në asamblën e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblën e përgjithshme.
Autorizimi mund të jetet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njofitimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njofitum nëpërmjet postës elektronike. Njofitimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbyaj vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij nenit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuromi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë votë, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mijete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zgjedhimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimit i likuiduesve dhe të ekspertive kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshire përgatitjen e pasqyrave financiare dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Cdo ndryshim statut duhet te depozitohet prane QKR per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shqërise.

Neni 12

Përashtimi nga e drejta e votës

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngrijen e një padie ndaj tij nga shqëria;
- ç) dhënen ose jo të përfitimeve të reja.

2.Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuar vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Administratorë

(1) Asambleja e përgjithshme emrón një ose më shumë persona fizik si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

(3) Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Të dhënat e identifikimit: dhe z. **Andi Gjeta** shtetas Shqiptar, i biri i Ismetit-it me datelindje 25.08.1987, lindur ne Librazhd, dhe bantue ne Tirane, shtetas shqiptar, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar nepernjet leternjofitimit elektronik me nr 035279086.i pajisur me personal **1705280211**, me zotesi te plote per te vepruar do te jete Administrator i shoqerise.

Neni 14

Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e dytë rohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administratorit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- c) përgatisin dhe nënshkruanë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e urisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumenta përrapa asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohë e duhur për rr Ethanat, që kërçenojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detryueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të vegantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratorët janë te detyruar te therasin Asamblene e Përgjitheshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetë financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivitetet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjeter aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikua.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak⁺

pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikua.

Nëse asambleja e përgjithshme emrón më shumë se një administrator, ata e administrojnë

bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të

 5 

zakonshme. Padijtë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqérinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15 Pergjegjesite e Administratorit

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjive, për shkelje të statutit, apo për fajt të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit përkatësë,

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

a) të kryej detyrat e tij te përaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimitarës së shoqërisë në mëjdis;

b) të ushtrioj kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;

d) të ushtrioj detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për qdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rjedhin nga kryerja e shkelles, si dhe t'i kalojë qdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuari nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuar. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit .. Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;


c) u shpërndan aktivitet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimitarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohet që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrënë padi penale kundër administratorit përgjithësisht.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin finanziar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit përgjithësisht.



Kreu IV
Viti finanziar-ekspertet

Neni 16

Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylltet me 31 Dhjetor.

Neni 17

Eksperetet

Ekspereti ka per detyre qe tē kontrolloje tē gjithe dokumentacionin kontabel tē veprimitarise ekonomiko tregtare tē shoqerise, ate gjithevetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike tē ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje tē tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim tē kontrollit eksperti kontabel i autorizuar percatit raportin me shkrim per nxjerjen e rezultatit tē bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike tē ushtruara, tē cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e tē drejtës vendimore qe ka.

Kreu V

Prishja –riorganizimi i shoqërisë

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund tē behet ne edo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjata e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim tē Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave tē falimentimit
- ç) nese nuk ka kryer veprimitari tregtare pér dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimitarisë nē përpunthe me pikën 3 tē nenit 43 tē ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrén Kombëtar tē Regjistrimit";
- d) me vendim tē gjykates;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne tē cilin parashikojne menyren e likuidimit tē shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne edo dokument tē nxjer per tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave tē likuidimit nē gjendjen e aftësisë paguese, me përashtim tē rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

7

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19

Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednitit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 20

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislatacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqeritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 21

Mosmarrëveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptar.

ORTAKETE SHOQËRISE

"Futura Fusion Technology " SH.P.K

Rasim Jeshili



Dt.18.05.2022

Andi Gjeta

